



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Nr. 2218/1 prot.

Tiranë, më 31.5.2018

Lënda: Njoftim mbi rekomandimet dhe konkluzionet e takimit të gjashtë të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik

Znj. JULIANA HOXHA
DREJTOR EKZEKUTIV I PARTNERËVE PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM
NË SHQIPËRI

Tiranë

Z. AURON PASHA
DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT PËR KËRKIME DHE ALTERNATIVA
ZHVILLIMI

Tiranë

ZNJ. ALBANA DHIMITRI
DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT PËR POLITIKA PUBLIKE DHE PRIVATE

Tiranë

ZNJ. KRISELA HACKAJ
DREJTOR EKZEKUTIV I INSTITUTIT PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM

Tiranë

Z. ANDI DOBRUSHI
DREJTOR EKZEKUTIV I FONDACIONIT "SHOQËRIA E HAPUR
PËR SHQIPËRINË"

Tiranë

Z. KLODIAN SEFERAJ
MENAXHER I PROGRAMIT I FONDACIONIT "SHOQËRIA E HAPUR PËR
SHQIPËRINË"

Tiranë

ZNJ. DELINA NANO
DREJTOR EKZEKUTIV, IPSED

Tiranë

**Z. ELIAS MAZIOUM
DREJTOR EKZEKUTIV, SDA**

Tiranë

**Z. ERION TASE
DREJTOR EKZEKUTIV I AKADEMISË PËR STUDIMET POLITIKE**

Tiranë

Të nderuar,

Në vijim të shkresës sonë me nr.2218 prot., datë 8.5.2018, për organizimin e takimit të gjashtë të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave të Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik, që u zhvillua në datën 11.5.2018, ku morën pjesë përfaqësues nga institucionet shtetërore, donatorët dhe shoqëria civile, lutem gjeni bashkëlidhur konkluzionet operacionale të mbledhjes, të cilat do të shërbejnë si hapa të mëtejshëm në përmbushjen e synimeve dhe objektivave të këtij mekanizmi (bashkëlidhur, aneksi I).

Paketa e plotë informuese e zhvillimeve të takimit do të përcillet nga sekretariati teknik në formë elektronike.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

SENIDA MESI



**GRUPI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË POLITIKAVE
PËR MIRËQEVERISJE DHE ADMINISTRIM PUBLIK
KONKLUZIONE OPERACIONALE**

DATË: 16/05/2018

DREJTUAR NGA: Znj. Senida Mesi, Zëvendëskryeministër

VENDI: Tiranë, Zyra e Kryeministrit – “Holli
Protokollar”, COD (bashkëngjitur Agjenda
dhe Lista e pjesëmarrësve)

ÇËSHTJE PËR DISKUTIM:

Tema 1: Detyrat dhe roli i GMIP-së së Mirëqeverisjes

Tema 2: Raportim i Institucioneve mbi:

- i. ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të SIGMA / BE-së;
- ii. rekomandimet e PAR-Special Group.

Tema 3: Diskutimi dhe miratimi i plan-veprimit të rishikuar të Strategjisë SNRAP për 2018-2020 dhe i raportit të monitorimit të SNRAP për vitin 2017

KONKLUZIONE OPERACIONALE

- Miratimi i Planit të Ri të Veprimit 2018-2020 për Strategjinë e Administratës Publike dhe Raportin mbi Monitorimin 2017 për SNRAP;
- Ministria e Drejtësisë duhet të paraqesë një Raport mbi Strategjinë Kundër Korrupsionit në takimin e ardhshëm të GMIP;
- Planifikim dhe monitorim më i mirë nga të gjitha ministritë e linjës;

- Buxhetimi i strategjive duhet të adresohet siç duhet;
- Një Plan i qartë Veprimi për Rekomandimin e SIGMA-s për çdo institucion përkatës do të ndiqet nga Sekretariati Teknik në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e linjës;
- Takimi i dytë i GMIP për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike duhet të zhvillohet në qershor për të diskutuar tema si Antikorrupsioni dhe Qeverisja Lokale, Raportimi i progresit në Planin e Veprimit për rekomandimet e SIGMA.